



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit
Sh.02.Nr.31 datë:27.02.2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), neni 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitat e Rregullores së MAPL Nr. 02/2021 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunës, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenin 70, paragrafi 70.1, shkronja b) dhe nenin 82 të Statutit Sh.02 Nr. 20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Me qëllim të inicimit të procedurës për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Sh.01 Nr. 34774, datë 01.11.2024, për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike në Komunën e Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për formimin e grupit punues për plotësim dhe ndryshimin e Rregullores Sh.01 Nr. 34774, datë 01.11.2024, për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike në Komunën e Kamenicës

- 1. FORMOHET** grupi punues për hartimin e Draft-Rregullores për plotësim dhe ndryshimin e Rregullores Sh.01 Nr. 34774, datë 01.11.2024, për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike në Komunën e Kamenicës, Përbërja e grupit punues është si vijon:
 - 1.1.** Hysen Jerliu (DSHPAIE), kryesues;
 - 1.2.** Arif Skoverqani (DUPH), anëtar;
 - 1.3.** Besim Morina (DSHPAIE), anëtar;
 - 1.4.** Enis Fazliu (ZK), anëtar;
 - 1.5.** Ramize Rrudhani (Ndërmarrja Publike Lokale "Dardana" Sh.A), anëtare; dhe
 - 1.6.** Florentina Kryeziu (DSHPAIE), anëtare.
- 2.** Grupi punues është përgjegjës për hartimin e projekt-propozimit sipas pikës 1 të këtij vendimi, për marrjen e propozimeve dhe komenteve nga drejtoritë përkatëse, për organizimin e diskutimeve publike dhe vendimmarrjen mbi pranimin ose refuzimin e tyre, si dhe për hartimin e raportit të shqyrtimit publik dhe për përmbushjen e çdo detyrimi tjetër që rrjedh nga dispozitat ligjore.
- 3.** Mandati i komisionit zgjat deri në përfundimin e procedurave të hartimit dhe konsultimit publik të Draft-Rregullores, miratimin e saj nga Kuvendi i Komunës, si dhe deri në marrjen e konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

4. Bashkëngjitur këtij Vendimi është Rregullorja Sh.01 Nr. 34774, datë 01.11.2024, për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike në Komunën e Kamenicës
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Drejtorive Komunale; dhe
- QSHQ – arkivit.

Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIK E KOSOVO KOMUNA E KAMENICES - OPŠTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. 02	Nr./Br./No. 6036
Nr./faq. Br./str. No./Pg. 1	Data/ Datumi/ Date 09/03 2026
KAMENICE - KAMENICA	

Zyra e Kryetarit
Zyra e Prokurimit
Sh.02.Nr.17 datë:09.03.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Vendimit Sh.02, Nr. 24199, datë 04.09.2025 për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të kontratës, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenica, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshim dhe plotësim të Vendimit Sh.02, Nr. 24199, datë 04.09.2025

- NDRYSHOHET** paragrafi 1.1 e pikës 1 të Vendimit Sh.02, Nr 24199, datë 04.09.2025 për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të kontratës me titull ” **“Lot 6 – Transporti i nxënësve në SHFMU 17 Shkurti në Muqivërc”**, dhe riformulohet si në vijim:

1.1. Në vend të: **z. Agim Shkodra** (Drejtor i SHMLM “Sejdi Kryeziu”, Rogaçicë), i cili ishte caktuar menaxher i kontratës, **CAKTOHET: z. Milaim Lenjani** (U.D i SHMLM “Sejdi Kryeziu”, Rogaçicë”), **menaxher i kontratës**.
- Të gjitha dispozitat tjera të Vendimit Bazë Sh.02, Nr. 24199 datë 04.09.2025 mbesin në fuqi.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe është pjesë përbërëse e Vendimit.
- Shtojcë: Kopja e Vendimit Bazë Sh.02, Nr. 24199, datë 04.09.2025, dhe kontrata Sh.02 Nr. 23890 e datës 01.09.2025.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- Z.Agim Shkodra
- Z.Milaim Lenjani (U.D. i SHMLM “Sejdi Kryeziu”, Rogaçicë”)
- QSHQ-arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 6032

Nr. i faq. 1 Data: 09/03
Br. Str. Datum:
No Pg. Diti:

KAMENICË - KAMENICA 2826

Zyra e Kryetarit
Zyra e Prokurimit

Sh.02.Nr.18 datë:09.03.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Vendimit Sh.02, Nr. 24512, datë 04.09.2025 për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të kontratës, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenica, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshim dhe plotësim të Vendimit Sh.02, Nr. 24512, datë 04.09.2025

1. **NDRYSHOHET** paragrafi 1.1 e pikës 1 të Vendimit Sh.02, Nr 24512, datë 04.09.2025 për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të kontratës me titull " **Lot 13 – Transporti i nxënësve të SHMLM Sejdi Kurteshi në Kamenicë që të transportohen nga fshati Shipashnicë e Poshtme, fshati Muqivërc deri në Rogaçicë dhe anasjelltas.**", dhe riformulohet si në vijim:

1.1. Në vend të: **z. Agim Shkodra** (Drejtor i SHMLM "Sejdi Kryeziu", Rogaçicë), i cili ishte caktuar menaxher i kontratës, **CAKTOHET: z. Milaim Lenjani** (U.D i SHMLM "Sejdi Kryeziu", Rogaçicë"), **menaxher i kontratës.**

2. Të gjitha dispozitat tjera të Vendimit Bazë Sh.02, Nr24512, datë 04.09.2025 mbesin në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe është pjesë përbërëse e Vendimit.
4. Shtojcë: Kopja e Vendimit Bazë Sh.02, Nr. 24512, datë 04.09.2025, dhe kontrata Sh.02 Nr. 23848 e datës 01.09.2025

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- Z.Agim Shkodra
- Z.Milaim Lenjani (U.D. SHMLM "Sejdi Kryeziu", Rogaçicë)
- QSHQ-arkivi.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY

QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRADANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z./IS. 02 Nr./Br./No. 6039
Nr i faq 01 Data 09/03/2026
Br. St. Datum
No Pg Dat
KAMENICË - KAMENIC

Zyra e Kryetarit
Zyra e Prokurimit

Sh.02.Nr.16 datë:09.03.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Vendimit Sh.02, Nr. 24515, datë 04.09.2025 për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të kontratës, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenica, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshim dhe plotësim të Vendimit Sh.02, Nr. 24515, datë 04.09.2025

1. **NDRYSHOHET** paragrafi 1.1 e pikës 1 të Vendimit Sh.02, Nr 24515, datë 04.09.2025 për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të kontratës me titull "Lot 14 – Transporti i nxënësve të SHMLM në Rogaçicë, që transportohen nga fshati Karaçevë e Epërme, Karaçevë e Poshtme dhe fshati Novosellë deri në Rogaçicë dhe anasjelltas", dhe riformulohet si në vijim:

1.1. Në vend të: **z. Agim Shkodra** (Drejtor i SHMLM "Sejdi Kryeziu", Rogaçicë), i cili ishte caktuar menaxher i kontratës, **CAKTOHET: z. Milaim Lenjani** (U.D i SHMLM "Sejdi Kryeziu", Rogaçicë), **menaxher i kontratës**.

2. Të gjitha dispozitat tjera të Vendimit Bazë Sh.02, Nr24515, datë 04.09.2025 mbesin në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe është pjesë përbërëse e Vendimit.
4. Shtojcë: Kopja e Vendimit Bazë Sh.02, Nr. 24515, datë 04.09.2025, dhe kontrata Sh.02 Nr. 23979 e datës 01.09.2025

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z.Agim Shkodra
- z.Milaim Lenjani (U.D. i SHMLM "Sejdi Kryeziu", Rogaçicë)
- QSHQ-arkivi.

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES
OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY

02 KRYETARI I KOMUNES
PRESDENNIK OPŠTINE

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY

QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z./IS. 02 Nr./Br./No. 6093
Nr. ftd. 01 Data 09/03/
Br. Str. 01 Data 2026
No. Pg. 01 Data 2026
KAMENICË - KAMENICA

Zyra e Kryetarit
Zyra e Prokurimit

Sh.02.Nr.16 datë:09.03.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Vendimit Sh.02, Nr. 24515, datë 04.09.2025 për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të kontratës, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenica, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

V E N D I M


Për ndryshim dhe plotësim të Vendimit Sh.02, Nr. 24515, datë 04.09.2025

- NDRYSHOHET** paragrafi 1.1 e pikës 1 të Vendimit Sh.02, Nr 24515, datë 04.09.2025 për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të kontratës me titull " **Lot 14 – Transporti i nxënësve të SHMLM në Rogaçicë, që transportohen nga fshati Karaçevë e Epërme, Karaçevë e Poshtme dhe fshati Novosellë deri në Rogaçicë dhe anasjelltas**", dhe riformulohet si në vijim:

1.1. Në vend të: **z. Agim Shkodra** (Drejtor i SHMLM "Sejdi Kryeziu", Rogaçicë), i cili ishte caktuar menaxher i kontratës, **CAKTOHET: z. Milaim Lenjani** (U.D i SHMLM "Sejdi Kryeziu", Rogaçicë"), **menaxher i kontratës**.
- Të gjitha dispozitat tjera të Vendimit Bazë Sh.02, Nr24515, datë 04.09.2025 mbesin në fuqi.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe është pjesë përbërëse e Vendimit.
- Shtojcë: Kopja e Vendimit Bazë Sh.02, Nr. 24515, datë 04.09.2025, dhe kontrata Sh.02 Nr. 23979 e datës 01.09.2025

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z.Agim Shkodra
- z.Milaim Lenjani (U.D. i SHMLM "Sejdi Kryeziu", Rogaçicë)
- QSHQ-arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z. /S. 02 Nr./Br./No. 6251
Nr. ffaq 01 Data 10/03/2026
Br. Str. _____ Datum _____
No. Pç. _____ Dat. _____

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit
Sh.02.Nr.38, datë 10.03.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, shkronja g) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 26 dhe nenit 28 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 20/2016"), si dhe nenit 70, paragrafi 70.2, shkronja e) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Zotrim Kastrati (DSHPAIE) autorizohet të nënshkruajë "Marrëveshjet për Pagesën e Borxheve" ndërmjet shfrytëzuesve të kiosqeve dhe Komunës së Kamenicës.
2. Autorizimi i dhënë sipas pikës 1 të këtij vendimi nuk mund të bartet tek zyrtarët e tjerë.
3. Autorizimi i dhënë sipas pikës 1 të këtij vendimi vlen vetëm për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet shfrytëzuesve të kiosqeve dhe Komunës së Kamenicës.
4. Z. Zotrim Kastrati është i obliguar të mbajë evidencë për marrëveshjet e nënshkuara dhe të raportojë lidhur me to, sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës.
5. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:


- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- z. Zotrim Kastrati (DSHPAIE); dhe
- QSHQ-Arkivi.

Kryetari i Komunës


Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.nr.37, datë: 09.03.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008), nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në neni 70, paragrafi 70.1, shkronja b), dhe nenin 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, dhe duke u bazuar në nevojën për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM

Për formimin e Ekipës Monitoruese për implementimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal

1. Formohet Ekipa Monitoruese për implementimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal, me përbërjen e mëposhtme:
 - 1.1. Valdete Sopi (DZHED) – Kryesuese;
 - 1.2. Vjollca Azemi (DBF) – Anëtare; dhe
 - 1.3. Besarta Ahmeti (DKA) – Anëtare
2. Anëtarët e Ekipës Monitoruese janë të obliguar të monitorojnë zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal, duke grumbulluar të dhëna, analizuar progresin dhe sugjeruar masat e nevojshme për përmirësim, dhe të raportojnë mbi përparimin dhe rezultatet e implementimit të Planit të Veprimit.
3. Ekipi Monitorues ka mandat për vitin 2026 për të monitoruar zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe për të raportuar mbi rezultatet.
4. Zbatimin e këtij vendimi e kryen Ekipa Monitoruese sipas përbërjes së përcaktuar në pikën 1, ndërsa mbikëqyrjen e zbatimit të tij e ushtron Kryetari i Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Ekipës Monitoruese; dhe
- QSHQ - Arkivit.


Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj






Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.39, datë: 12.03.2026

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, me qëllim të hartimit të projektit dhe paramasës teknike për ndërtimin e trotuarit në Karaçevë të Ulët, Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PROJEKTIT DHE PARAMASËS TEKNIKE PËR NDËRTIMIN E TROTUARIT NË KARAÇEVË TË ULËT

1. Formohet Komisioni për hartimin e projektit dhe paramasës teknike për ndërtimin e trotuarit në Karaçevë të Ulët.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1. Amire Ismajli, (Drejtorja për Investime Kapitale) – Kryesuese;
 - 2.2. Imran Morina, (Drejtorja për Investime Kapitale) – Anëtar; dhe
 - 2.3. Vullnet Ajvazi, (Kompania Gjeodezike – GeoMetric) – Anëtar.
3. Komisioni ka për detyrë hartimin e projektit dhe paramasës teknike për ndërtimin e trotuarit në Karaçevë të Ulët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet teknike përkatëse.
4. Projekti dhe paramasa teknike duhet të hartohen dhe dorëzohen brenda një afati prej 20 ditësh pune.
5. Mandati i Komisionit për hartimin e projektit dhe paramasës teknike për ndërtimin e trotuarit në Karaçevë të Ulët, përfundon me dorëzimin e projektit dhe paramasës.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendim t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Anëtarëve të Komisionit; dhe
- QSHQ – Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo


REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY

QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐEVINARSTVA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z./S. 021 Nr./Br./No. 6513

Nr. i fsh. Data 12103
Nr. Str. Datum Dite
KAMENICE - KAMENICA 2026

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.40, datë: 12.03.2026

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, me qëllim të hartimit të projektit dhe përgatitjes së paramasës teknike për rregullimin e oborrit të Shkollës ‘Hasan Prishtina’ në fshatin Busavatë, Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PROJEKTIT DHE PARAMASËS TEKNIKE PËR RREGULLIMIN E OBORRIT TË SHKOLLËS “HASAN PRISHTINA” NË FSHATIN BUSAVATË

1. Formohet Komisioni për hartimin e projektit dhe paramasës teknike për rregullimin e oborrit të Shkollës ‘Hasan Prishtina’ në fshatin Busavatë.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1. Vjollcë Kryeziu, (Drejtorja për Investime Kapitale) — Kryesuese;
 - 2.2. Diamant Latifaj, (ProGeo Consulting, Kamenicë) — Anëtar; dhe
 - 2.3. Vlonë Matoshi, (Drejtorja për Investime Kapitale) — Anëtare.
3. Komisioni ka për detyrë hartimin e projektit dhe paramasës teknike për rregullimin e oborrit të Shkollës ‘Hasan Prishtina’ në fshatin Busavatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet teknike përkatëse.
4. Projekti dhe paramasa teknike duhet të hartohen dhe dorëzohen brenda një afati prej 20 ditësh pune.
5. Mandati i Komisionit për hartimin e projektit dhe paramasës teknike për rregullimin e oborrit të Shkollës ‘Hasan Prishtina’ në fshatin Busavatë, përfundon me dorëzimin e projektit dhe paramasës.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.


Vendim t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Anëtarëve të Komisionit; dhe
- QSHQ – Arkivit.






Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.nr.44, datë: 17.03.2026

Bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008 ; Nenin 20 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 14/2019); Nenin 6 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionalizimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, si dhe neni 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë vendim:

VENDIM

Për ri-konstituimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës

1. Miratohet ri-konstituimi i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës për zbatimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 në Komunën e Kamenicës, në përbërjen e mëposhtme:
 - 1.1. Kadri Rahimaj - Kryesues – Kryetari i Komunës së Kamenicës;
 - 1.2. Besart Kryeziu - Zëvendëskryesues – Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.3. Selami Klaiqi - Anëtar – Drejtorja Komunale e Arsimit;
 - 1.4. Afrim Dërvishi - Anëtar – Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport;
 - 1.5. Ardita Dërmaku - Anëtare – Drejtorja për Buxhet dhe Financa;
 - 1.6. Arbnora Beqiraj Fera - Anëtare – Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës;
 - 1.7. Ivan Markovic - Anëtar – Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës;
 - 1.8. Nazmije Demolli Kastrati - Anëtare – Zyrtare për të Drejtat e Fëmijëve – Njësia për të Drejtat e Njeriut;
 - 1.9. Petrit Isufi- Anëtar – Përfaqësues i Policisë;
 - 1.10. Kimete Kryeziu - Anëtare – Zyrtare e Qendrës për Punë Sociale; dhe
 - 1.11. Lavdim Klaiqi - Anëtar – Përfaqësues i Shoqërisë Civile.
2. Anëtarët vëzhgues dhe këshilltarë të jashtëm:
 - 2.1. Fikrije Shkodra - Përfaqësuese e Këshillit të Prindërve;
 - 2.2. Mirsije Ajvazaj - Përfaqësues/e i Avokatit të Popullit;
 - 2.3. Faruk Dërmaku - Përfaqësues i Organizatave Ndërkombëtare – OSBE-së; dhe
 - 2.4. Sherafedin Vranja - Përfaqësues/e i Organizatave Vendore.
3. Sekretariati i Ekipit caktohet të Zyrtarja për të Drejtat e Fëmijëve – Njësia për të Drejtat e Njeriut pranë Komunës, mbështetur nga Kabineti i Kryetarit, për të koordinuar, monitoruar

dhe zhvilluar aktivitetet e nevojshme për punën e Ekipit.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Ekipit përcaktohen sipas Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, **shfuqizohet** Vendimi Sh.02.Nr.6391 i datës 28.02.2023, për caktimin e grupit të punës për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës dhe Vendimi Sh.02.Nr.33704, i datës 22.10.2024 për Ndryshim dhe Plotësim të Vendimit Sh.02.Nr.6391 e datës 28.02.2023 për Caktimin e Grupit të punës për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të Drejtat e Fëmijës.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i`u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Ekipës për të Drejtat e Fëmijës; dhe
- QSHQ - Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo


REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA
KAMENICE - KAMENICA
Komunë e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

QENDRA PËR SHËRBIMIN
CENTAR ZA USLUGU GRADANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 7085
1 19/03/2026

Nr. ifaq
Br. Str.
No. Pg.

Data
Datum
Date



Zyra e Kryetarit

Sh.02 Nr.45, datë: 19.03.2026

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016), nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, Vendimit Sh.02.Nr.31747 të datës 13.11.2025 për formimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve sipas thirrjes publike Sh.02.Nr.31656, e datës 12.11.2025 për subvencionimin me "baby box" (pako me rroba dhe produkte të rëndësishme për foshnje), si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Sh.02.Nr.31747 të datës 13.11.2025 për formimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve sipas thirrjes publike Sh.02.Nr.31656, e datës 12.11.2025 për subvencionimin me "baby box" (pako me rroba dhe produkte të rëndësishme për foshnje)

- Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.2 (një pikë dy) i Vendimit Sh.02.Nr.31747 të datës 13.11.2025 për formimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve sipas thirrjes publike Sh.02.Nr.31656, e datës 12.11.2025 për subvencionimin me "baby box" (pako me rroba dhe produkte të rëndësishme për foshnje).
 - Paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.2 (një pikë dy) i Vendimit Sh.02.Nr.31747 të datës 13.11.2025, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të anëtarit të komisionit z. **Edon Dërmaku (DZHED)**, caktohet anëtar i ri në komision z. **Selmon Kryeziu (DBF)**.
- Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë Sh.02.Nr.31747 të datës 13.11.2025.
- Këtij vendimi i bashkëngjitet kopja e Vendimit bazë Sh.02.Nr.31747 të datës 13.11.2025 dhe Thirrja Publike Sh.02.Nr.31656, e datës 12.11.2025 për subvencionimin me "baby box" (pako me rroba dhe produkte të rëndësishme për foshnje).
- Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim të njoftohet: Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, z. Edon Dërmaku (DZHED), z. Selmon Kryeziu (DBF), Anëtarëve të komisionit sipas Vendimit Sh.02.Nr.31747 të datës 13.11.2025 dhe Q.SH.Q - arkivit.



Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARE CENTAR ZA USLUGU GRADANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. 02	Nr./Br./No. 7279
Nr. ifaq Br. Str. No. Pg. 1	Data Datim Date 23/03
KAMENICË - KAMENICA 2026	

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit
Zyra e Prokurimit

Sh.02 nr.20 datë: 23.03.2026

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 22 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenin 10 paragrafi 10.1 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe bazuar në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit me numër Sh.02. nr. 6939 e datës 17.03.2026 për projektin **“Furnizimi me Dru”** dhe nenin 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

V E N D I M

1. CAKTOHET, z. **Selami Klaiqi**, Zyrtar Autorizues për projektin: **“Furnizimi me Dru”** Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t’i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkuara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
2. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit të Zyrtari i Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit, së bashku me kopjen e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërinë për Disponueshmërinë e Fondeve.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi është përgjegjës Zyrtari Autorizues, z. **Selami Klaiqi**, për projektin: **“Furnizimi me Dru.”**
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.


Vendimi t’i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Selami Klaiqi (DKA); dhe
- Arkivi.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit (Nr. 03/L-040) për Vetëqeverisje Lokale, neni 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 70 paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh. 01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, neni 7 dhe 22 I Rregullores Sh. 01.nr. 31251 të datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Kamenicës, si dhe Kërkesës Sh.02. Nr.6012 e datës 09.03.2026 për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve – Prodhues të Qumështit për 6M-2 (Korrik – Dhjetor) 2025, si dhe Thirrjes Publike Sh. 11, Nr. 3040 e datës 03.02.2026 e parashtruar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kryetari I Komunës merr këtë:


VENDIM

- FORMOHET** - komisioni i përbashkët për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve – Prodhues të qumështit për 6M-2/2025 (Korrik-Dhjetor) me këtë përbërje:
